

SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 20127/16

Rudina Proda kundër Shqipërisë (shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 5 maj 2022, si Komision, i përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *Zëvendësregjistrare e Përkohshme e Seksionit;*

Pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme paraqitur më 5 prill 2016;

Duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkujes janë paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Kërkuesja u përfaqësua nga znj. T. Proda, nëna dhe kujdestarja e saj ligjore.

Ankesat e kërkujes në mbështetje të nenit 6§1 dhe të nenit 13 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin e vonuar të një vendimi të brendshëm, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë (Qeveria).

LIGJI

Pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, Qeveria bëri me dije Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë për zgjidhjen e problematikave të ngritura me anë të këtyre ankesave. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës që të përjashtonte kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Qeveria pranonte se ekzekutimi i vonuar i vendimit nr. 558, i datës 6 maj 2004, i Gjykatës së Apelit Tiranë, ishte në shkelje të nenit 6§1 të Konventës. Gjithashtu, Qeveria i bëri me dije Gjykatës, se vendimi ishte ekzekutuar plotësisht. Qeveria ofronte t'i paguante kërkujes shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve, në përputhje me nenin 37§1(c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes dhe do të shlyhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mosshlyerjes së kësaj shume brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj saj, që prej përfundimit të asaj periudhe deri në shlyerje, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkueses iu dërguan kushtet e deklaratës së bërë nga ana e Qeverisë, disa javë përpara datës së këtij vendimi. Ajo nuk i pranoi kushtet e deklaratës.

Gjykata nënvizon se neni 37§1(c) i jep të drejtën që ta përjashtojë çështjen nga lista e saj, nëse:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës.”.

Në këtë mënyrë, ajo mund të përjashtojë kërkesat, në përputhje me nenin 37§1(c) mbështetur në deklaratën e bërë nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkuesi dëshiron që shqyrtimi i çështjes të vijojë (shih, veçanërisht, vendimin *Tahsin Acar kundër Turqisë* (objeksione paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§ 75–77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka një praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë, në lidhje me ankesat që kanë të bëjnë me mosekzekutimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve të brendshme (shih, për shembull, *Qufaj Co.*

sh.p.k. kundër Shqipërisë, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

Duke mbajtur në konsideratë pohimet në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – e cila përkon me shumën e akorduar në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson se nuk është e justifikueshme që të vijohet me shqyrtimin e pjesës së kërkesës së trajtuar në deklaratën e bërë nga ana e Qeverisë (neni 37§1(c)).

Duke marrë në konsideratë vlerësimet e mësipërme, Gjykata krijon bindjen se në respektim të të drejtave të njeriut, sipas parashikimeve në Konventë dhe në Protokollet e saj, Gjykatës nuk i kërkohet që të vijojë me shqyrtimin e pjesës në fjalë të kërkesës (neni 37§1 *in fine*).

Në fund, Gjykata thekson se nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratën e saj, kërkesa mund të rikthehet në listë, në përputhje me nenin §2 të Konventës (shih *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Mbështetur në sa më sipër, është me vend që kërkesa, me këtë ankesë konkrete, të përjashtohet nga lista e çështjeve, sipas nenit 6§1 të Konventës.

Në vijim, kërkesja u ankua, në përputhje me nenin 13 të Konventës, për mungesën e një zgjidhjeje efektive për sa i përket ekzekutimit të vonuar të vendimeve. Duke pasur në konsideratë faktet e çështjes, deklaratën e bërë nga ana e Qeverisë dhe vendimin e Gjykatës për ta përjashtuar ankesën në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, Gjykata gjykon se çështja ligjore e ngritur në kërkesën në fjalë është zgjidhur. Kështu, Gjykata arrin në përfundimin se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet kjo pjesë e kërkesës.

Për këto arsye, në mënyrë unanime, Gjykata:

Mban në konsideratë kushtet në deklaratën e Qeverisë së paditur, si edhe masat për të garantuar premtimet në këtë deklaratë;

Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve, për sa i përket ankesës bërë sipas nenit 6 §1 të Konventës, në përputhje me nenin 37§1(c) të Konventës;

Vendos se nuk është e nevojshme që të shqyrtohet pjesa e mbetur e kërkesës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 25 maj 2022.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSREGJISTRARE E PËRKOHSHME

Andreas Zünd
KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesë e cila parashtron ankesa, sipas nenit 6§1 të Konventës (mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. ..., data e paraqitjes	Emri i kërkuesit, viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së komenteve të kërkuesit, nëse ka ndonjë të tillë	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot e shpenzimet (në euro) ¹
20127/16, 5.4.2016	Rudina PRODA 1978	Proda Theodhora Tiranë	17.1.2022	8.2.2022	2500

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.